




Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivety	16.12.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	6201/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.948/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari –dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.976/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 11.11.2021, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.53/2020 të datës 26.02.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, kundër institucionit punëdhënës “Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.12.2021 mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.53/2020 e datës 26.02.2020 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ndaj ankueses sipas shkresave të lëndës e punësuar në pozitën “Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore” në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, Drejtoresha e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore me datë 05.11.2019 ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Ankuesja, e pakënaqur në vendin e punës me supozimin se ndaj saj është duke u bërë presion psikik nga Drejtoresha e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore, me datë 26.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 509/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 04.03.2020, me numër protokollit:553/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa me datën 10.03.2020 me numër protokollit 644/2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 14.05.2020,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 27.09.2021 ka nxjerr Aktvendimin A.nr.976/20 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të jap përgjigje në padi lidhur me ankesën e ankueses Këshilli me datë 14.10.2021 ka kthyer Gjykatës përgjigje në padi me numër prot:5026/2021 në dy ekzemplar sipas kërkesës.

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 11.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.976/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 14.05.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 26.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.02.2020 me numër protokoll 509/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresa e datës 26.02.2020; Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor e datës 05.11.2019; Ankesa e datës 16.12.2019 e Parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi i datës 17.07.2019; Plotësim Ndryshimi i akt emërimit të datës 19.07.2019; Përshkrimi i detyrave të punës për ankuesen; E-maili i datës 25.10.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; E-maili i datës 23.10.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; E-maili i datës 17.12.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; Emaili i datës 11.04.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; Emaili i datës 19.02.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; Emaili i datës 15.02.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; E-maili i datës 08.02.2019 me korrespondencën e bashkangjitur; E-maili i datës 19.12.2018 me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; E-maili i datës 19.12.2018 me korrespondencën e bashkangjitur prej shtatë (7) faqesh; Dokumenti i bashkangjitur mbi hulumtimin e opinionit publik nga Instituti për kriminologji dhe Kriminologji; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 04.03.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 10.03.2020 me numër protokoll 644/2020; Ankesa e ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave e datës 05.03.2020; E-maili i datës 21.02.2020 me vendimin e bashkangjitur për shtyrjen e afatit për vendosje deri me datë 28.02.2020; E-maili i datës 02.03.2020 dërguar nga

Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 28.02.2020; Vendimi i Komisionit Disiplinor për korrigjimin e këshillës juridike i datës 28.02.2020; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 19.01.2020; Procesverbali i Komisionit i datës 27.02.2020; Emaili i datës 03.03.2020; Rregullorja për organizimin e Brendshëm të Aviacionit të Aviacionit Civil së bashku me Organogramin e strukturës organizative; E-mailin datës 17.01.2020 dërguar nga për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej katër faqesh; E-mailin e datës 19.02.2019 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej shtatë (7) faqesh; E-mailin e datës 15.02.2021 dërguar nga për me korrespondencën prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 15.02.2021 dërguar nga për me korrespondencën prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 16.02.2021 dërguar nga për me korrespondencën prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 17.01.2020 dërguar nga për me korrespondencën prej katër (4) faqesh; Njoftimin e datës 14.05.2020; Aktvendimin A.nr.976/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative të datës 27.09.2021; Përgjigjen në padi të datës 14.10.2021; Aktgjykimin A.nr.976/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative të datës 11.11.2021.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që **ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe analizimit të provave dhe fakteve të sjellura nga ankuesja si dhe nga institucioni në këtë rast Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ka konstatuar se kundër ankueses me datë 05.11.2019 Drejtoresha e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore në Komisioni Disiplinor, ndërsa ankuesja pretendon se lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore në fjalë është njoftuar me rastin e pranimit të kërkesës së përgjigjes në ankesë të datës 23.12.2019 lidhur me parashtrimin ankesës nga Drejtoresha e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore me datë 16.12.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e vendosjes e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)”* si dhe neni 127 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”,* si dhe dispozitat e neni 81 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë; 2.Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1.Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”,* po ashtu edhe me dispozitat e neni 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është përcaktuar se: *“Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”,* andaj mbi këtë bazë meqenëse ankuesja nuk ka bashkangjitur aktin administrativ apo nuk iu është referuar një akti administrativ të cilën e kundërshton me ankesën e parashtruar me datë 26.02.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar dhe e njëjta është bërë para se të shteren mundësitë ligjore brenda institucionit ku punon.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga shkresat e bashkangjitura e lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se ankuesja me datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave sipas udhëzimit në mjete juridike nga Komisioni Disiplinor përmes vendimeve të datës datë 28.02.2020 me numër prot:202/05/69 si dhe vendimit tjetër të së njëjtës datë me numër prot:2020/05/70 të cilët e kanë shpallur veten jo kompetentë lidhur me kërkesën e iniciimit të procedurës disiplinore ndaj znj.

nga ankuesja, andaj ngase u potencua si më lartë ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 26.02.2020 në Këshill ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës neni 16 paragrafit 4 të si dhe me dispozitat e neni 81 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po që ankuesja nuk ka sjellë asnjë dëshmi apo provë që para parashtrimit të ankesës së datës 26.02.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ketë parashtruar fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa ankesa e bashkangjitur me përgjigjen në kërkesë të datës 10.03.2020 e vërteton konstatimin e Kolegjit se ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pasi që e ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.948/2021

Flakron GASHI


Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses*
- *Drejtorit të Përgjithshëm Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës*
- *Menaxherit të Personelit në Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;*
- *Gjyqtarit Krenar Berisha, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

